



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 407/2014

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani, kryesues, Ymer Hoxha, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Sadri Ferati nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Mitrovicë, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me dt. 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

#### VENDIM

- I. Miratohet** si e bazuar ankesa e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Sadri Ferati nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Mitrovicë.
- II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), ti rinumëroi vetëm fletëvotimet për kandidatët e subjektit politik (LDK) në vendvotimin (VV) 1116D/03D.
- III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit të VV si në pikën II të këtij dispozitivi, të përfshihet në rezultatit përfundimtar.

#### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës Sadri Ferati nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, dega në Mitrovicë, me të cilën pretendon se ka vërejtur një gabim apo moskujdesje të kryesuesit në VV 1116D/03D ku votat e kandidatit në fjalë me nr. 38 janë bartur tek numri 39 kandidati Naim Behluli gjatë plotësimit të FRK-së.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmisë ka ofruar deklaratën e Agush Xhemajli.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së “Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme “

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri administrimin e materialit zgjedhor konstatoi se:

### **ankesa është e bazuar**

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidati Sadri Ferati nga subjekti politik (LDK), dega në Mitrovicë, dhe në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të fletëvotimeve për të cilat kandidati në fjalë pretendon në ankesën e tij se është dëmtuar nga mos procedimi i votave në FRK nga ana e Kryesuesit të VV 1116D/03D.

Nga ekipi i PZAP-it është konstatuar se kutia e votimit me nr. 1116D/03D për Komunën e Mitrovicës ishte e mbyllur prej 4 shiritave anësorë të sigurisë dhe një shiriti në mes të kutisë. Shiratat anësor të kutisë kanë nr. 147880, 147878, 147879 dhe 147877 ndërsa shiriti i mesëm nr. 177871 i cili nuk ishte i prekur fare

Në vazhden e hetimit, ekipi i PZAP-it ka konstatuar se nga origjinali i FRK-së që gjendet në QNR, kandidati me nr 38 nga radhët e subjektit politik LDK nuk posedon asnjë votë, ndërsa pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutinë e votimit 1116D/03D del se janë 46 fletëvotime të vlefshme të kandidatit në fjalë. Pas përfundimit të hetimit, komisioni hetues gjeti se thesi brenda kutisë ishte mbyllur me shiritin e sigurisë me nr.076783 dhe mbyllja e kutisë me shirita të sigurisë si 051754, 051753, 051752, dhe 051751.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe nga deklaratat e vëzhguesit del se kandidati me nr 38 ka poseduar 46 vota, dhe se gjatë plotësimit të FRK-së ka pasur një lëshim në VV e cekur më lartë, me ç'rast 46 votat e kandidatit Sadri Ferati nuk ishin përfshirë në rezultatet përfundimtare të shpallura nga ana e KQZ-së

Prandaj me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenin 115.1, 117.4 dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

Anr. 407/2014 më datën 30.06.2014



#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*